



KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 06-07-2023		
Njësi.org. Org. led.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
15-401/04-0046031/23		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

RAPORTI PUNËS

(Janar – Qershor, 2023)

- Është miratuar në Kuvend dhe aprovuar nga MAPL, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025.
- Janë mbështetur 16 biznese me mbulimin e 30% të kostos së blerjeve të makinerisë prodhuese në kuadër të thirrjes publike “Subvencionimi i kapaciteteve prodhuese të NMVM-ve”.
- Në kuadër të Turizmit kemi filluar punimet për ndërtimin e shtigjeve të ecjes, vendosjen e ulseve dhe shportave për mbeturina në fshatrat Zakut-Pakashticë dhe Shakovicë-Bellopojë.
- Në bashkëpunim me EKW Janë furnizuar 5 përfitues/e me fidane të Shërbelës dhe farë të Facelias me qëllim të rritjes së prodhimtarisë së mjaltës.
- Janë zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme dhe është bërë shpallja publike për PPP “Parkingun nëntokësor”.
- Është angazhuar kompani profesionale për përgaditjen e projekteve dhe aplikimin për fermer dhe biznese në grantet e MBPZHR-së.
- Është bërë përditësimi i katalogut dhe hartës digjitale – platformës online të parcelave komunale për dhënje në shfrytëzim.
- Inicimi i procedurave për krijimin e zyrës së diasporës dhe angazhimin e dy konsulentëve për investime dhe bashkëpunim me diasporë.
- Inicimi i procedurës së furnizimit me 100 mjete/pajisje pune për biznese start-up dhe ekzistuese (Rrobaqepësi, Automekanik, Hekrari etj.)
- Inicimi i procedurave për krijimin e broshurës “Podujeva në figura 2023” me karakteristikat e ndryshme të Podujevës, të paraqitura përmes figurave.
- Janë mbajtur sesione informuese dhe asistencë për qytetarë/biznese lidhur me aplikimet në skemat e granteve të publikuara nga MZHR, MINT etj.
- Janë pajisur me çertifikata të stazhit të punës sipas kërkesa të parashtruara pranë drejtorisë.

- Lidhur me krijimin/themelimin e Zonës Industriale janë mbajtur dëgjime publike dhe takime në ministri relevante, janë realizuar të gjitha procedurat e nevojshme, është bërë shpronësimi i pronës ku do të ndërtohet Zona Industriale me sipërfaqe rreth 30ha dhe tani jemi në fazën e themelimit të Zonës Industriale.
- Jemi në fazën përfundimtare për themelimin e Ndërmarrjes publike komunale për të ofruar shërbime publike më të mira dhe me kosto më të ulët.
- Sektori i regjistrimit të Bizneseve ka realizuar këto punë dhe aktivitete :

Nr.	Aktiviteti	Nr. i lëndëve
1.	Regjistrime të bizneseve të reja	148
2.	Shuarje të bizneseve	16
3.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	98
4.	Certifikata të reja (me nr.unik identifikues)	96
5.	Informata	51
	TOTALI	411

(Të dhënat e paraqitura në tabelë, janë prej 01.01.2023 deri më dt.27.06.2023)

- Janë ofruar këshilla dhe asistencë për bizneset, të rinjtë dhe qytetarët për fushën dhe kompetencën që ne mbulojmë.
- Janë mbajtur Takime dhe Punëtori të ndryshme me:
 - Kosovo Local Government - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale
 - MAPL – UN-Habitat – MMPH
 - AZHR – MZHR
 - MINT
 - WWFF Adria dhe MMPHI
 - Asociacioni i Komunave të Kosovës
- Të tjera...

06.07.2023

Drejtore i DPZHE:
R. Vigan Salihu

